



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

DSIK
DEKLASIFIKUAR PJESËRISHT
ME VENDIM TË KDZH
Nr. 3575, datë 30/10/2018

Nr. 19513 Prot

“Sekret”
Afati i klasifikimit 10 vjet
Kopje, nr. 1
Tiranë, më 2. 11. 2017

Lënda: Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit
Z. Adriatik Xhemal Llalla.

Drejtuar: KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

TIRANË

Në zbatim të kërkesave të nenit 39, pika 2, të Ligjit nr. 84/2016 “Për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit **Z. Adriatik Xhemal Llalla**, me detyrë Prokuror, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ju informon se:

1. Referuar Deklaratës për Kontrollin e Figurës së Subjektit të Rivlerësimit, Grupi i Punës shqyrtoi me kujdes dosjen e **Z. Adriatik Xhemal Llalla** dhe konstatoi se:

Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit Nr. 84/2016. Për verifikimin e kontrollit të figurës hartova shkresat drejtuar institucioneve [REDACTED].

2. Informacionet e ardhura nga institucionet e verifikimit

- [REDACTED]
- [REDACTED]
- [REDACTED]

3. Nga vlerësimi dhe analizimi i informacioneve të [REDACTED], rezulton se:

- a. Subjekti i rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla** ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në Deklaratën për Kontrollin e Figurës.

4. Bazuar në Deklaratën për Kontrollin e Figurës, Pjesa Nr. 5 (Të dhëna për sigurinë), germa e, u gjykua dërgimi i kërkesës për informacion në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), për të mësuar mbi vetë – deklarin e subjektit të rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla**, mbi rastet për pranim/shkëmbim parash, favoresh, dhuratash ose pasurish, për vete ose të afërmit.

- a. ILDKPKI informon se subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar:
- Kontratë shitje nr. 2072/986/rep/kol, datë 4.06.2016, për tokë të llojit ullishte, me sipërfaqe 3000 m², zona kadastrale 2704, Mjull Bathore, Tiranë, me palë shoqërinë "LIM EM" sh.p.k., në vlerën 249.000 Euro;
 - Huamarrje në shumën 20.000 euro nga shtetasi M L ;
 - Huamarrje në shumën 500.000 Lekë nga vjehri, F M ;
 - Huamarrje në vlerën 1.500.000 Lekë nga kunati, A M , emigrant në Mykonos, Greqi.
- b. Duke marrë shkas nga informacioni i ardhur nga ILDKPKI, për subjektin e rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla** u dërgua kërkesë për informacion shtesë [REDACTED].
- Në përgjigje Tonës, [REDACTED] informon se [REDACTED] por për shtetasit A B dhe Sh B , të përfshirë në marrëdhënie biznesi me subjektin e rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla**, [REDACTED].
- c. Duke marrë shkas nga informacioni i ardhur [REDACTED], për subjektin e rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla** u dërgua kërkesë për informacion shtesë [REDACTED] për shtetasit A B dhe S B .
- d. [REDACTED]
- e. [REDACTED], në përgjigjen shtesë informon se, pas verifikimeve të kryera, disponon të dhëna për shtetasin A B , i cili rezulton të ketë katër procedime penale të regjistruara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale si më poshtë vijon:
1. Për shtetasin A B , [REDACTED], më datë 17.02.2016, [REDACTED] referuar materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale "Punësim i paligjshëm" dhe "Fshehje e të ardhurave", parashikuar nga nenet 170/a dhe 180 i Kodit Penal, [REDACTED].
- Për shtetasin A B ka të dhëna të regjistruara për vepra penale në ngarkim të tij [REDACTED], konkretisht:
2. Më datë 23.06.2012, [REDACTED] referuar materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale "Shkelje e Rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, për arsye se ka goditur një këmbësor me automjet;

3. Më datë 17.01.2014, [REDAKTUAR] referuar materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale “Shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, për arsye se dyshohet se ka kryer punime në shtratin e lumit Tërkuzë në Tiranë, pasi i kishte skaduar afati i licencës së shfrytëzimit të lumit;
4. Më datë 20.12.2015, [REDAKTUAR] referuar materialet në Prokurorinë e rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, pasi gjatë një konflikti të çastit pranë lumit Tërkuzë, në fshatin Herraj, Tiranë, ka ushtruar dhunë ndaj një shtetasi.

Veçmas evidentohet se shtetasi A B , me vendim nr. 239, datë 07.05.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dënua me një vit burg për veprën penale të “Vjedhjes me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.

Duke marrë në konsideratë sa sipër arsyetohet se:

1. Për subjektin e rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla** administrohen informacione konfidenciale dhe informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas kërkesave dhe parashikimeve të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve/prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika nr. 6 dhe neni 38, pika 4, germa “c”, sepse shtetasi A B rezulton se:
 - a. Figuron person me precedentë kriminal/penal që prej vitit 1993, në mënyrë të përsëritur dhe në kohështrirje gjatë viteve 2012, 2014, 2015, 2016. A B është implikuar në disa forma të veprimtarive të paligjshme, [REDAKTUAR];
 - b. Duke marrë shkas nga informacioni [REDAKTUAR] për ekzistencën e katër referimeve në organin e akuzës në ngarkim të shtetasit A B , si dhe për shkak të përfundimit të afatit të parashikuar në ligj për procedurat e Kontrollit të Figurës, rekomandojmë që KPK t’i drejtojë kërkesë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për informacion mbi ecurinë e hetimeve për katër çështjet e referuara [REDAKTUAR] në ngarkim të shtetasit A B .
2. Nga informacioni i ILDKPKI dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 89, datë 03.02.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në R. SH., evidentohet se subjekti i rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla** ka lidhur një kontratë shitblerje me shtetasit A B dhe Sh B , interesat e së cilës janë dukshëm në favor të subjektit të rivlerësimit, pasi pasuria e patundshme në fjalë (e llojit tokë) është shitur disa herë më shtrenjtë se vlera e blerjes por edhe e çmimit real aktual të saj.
 - Rekomandojmë që KPK t’i drejtojë kërkesë ILDKPKI/Ministrisë së Drejtësisë/Dhomës Kombëtare të Noterisë/ Zyrës përkatëse të Noterisë, për t’u njohur me

kontratë e shitjes nr. 2072/986/rep/kol, datë 4.06.2016, me qëllimin për të mësuar origjinën e pronës tokë të llojit ullishte dhe vlerën e blerjes së saj nga subjekti i rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla**, pronë e cila është shitur më pas në vlerën prej 249.000 Euro;

3. Në këndvështrimin e përgjithshëm të integritetit dhe pastërtisë së figurës së një punonjësi të sistemit të drejtësisë, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mos përmbushje të rregullt të detyrës, dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jo materiale të padrejta për të si funksionar publik, cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë këtë individ të mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimit të germës "c", të nenit 37 të ligjit 84/2016;
4. Lidhur me pjesën nr. 5 të Deklaratës për Kontrollin e Figurës (të dhëna për sigurinë), germa g., subjektit të rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla** i është revokuar Viza Amerikane nga Ambasada e SHBA në Tiranë, në janar, 2017.
 - a. Kjo rrethanë është pasqyruar në Deklaratën për Kontrollin e Figurës, ku subjekti i rivlerësimit ka vetë deklaruar se Viza i është revokuar me argumentin se bashkëshortja e tij ka përdorur Vizën Diplommatike për vizitë jo diplomatike në SHBA.
 - b. Shqyrtimi i aplikimit për vizë të SHBA-së shoqërohet me verifikimin e besueshëm dhe profesional të aplikantit. Marrja e vizës së SHBA-së kuptohet si standard për pastërtinë e figurës ku aplikanti i nënshtrohet një procedure të imtësishe dhe të besueshme vettingu. Ndërkohë që refuzimi/revokimi i vizës mund të bëhet për disa arsye, sjellim në vëmendje se Ambasada e SHBA¹-ë ka deklaruar se do të përdorë të gjitha mjetet ligjore që ka në dispozicion për refuzimin/revokimin e vizave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar. Kjo praktikë është ndjekur nga SHBA për promovimin e luftës kundër korrupsionit, anembanë botës. Refuzimi i vizës përkon në periudhë me deklaratën e Ambasadës së SHBA-së. Në këtë kontekst rekomandojmë vlerësimin e këtyre rrethanave në dritën e informacioneve që KPK ka.

Sqarojmë se, përgjigjet që do të vijnë nga institucionet e verifikimit do të përcillen në vijim për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK-në).

Sa sipër, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve/prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pikat nr. 6, nr. 9 dhe nr. 14, ku përcaktohet se:

- "Kontakt i papërshtatshëm" është një takim, komunikim elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendoset marrëdhënie biznesi, ose ndonjë marrëdhënie tjetër;
- "Marrëdhënie biznesi" është çdo marrëdhënie profesionale ose tregtare, e cila lidhet me veprimtaritë e ushtruara nga subjektet e këtij ligji dhe klientët e tyre, që, në çastin e vendosjes së saj, vlerësohet të jetë një marrëdhënie e vazhdueshme ose

SEKRET

jo, sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;

- “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi, si dhe

Si dhe bazuar në nenin 38, pika 4, germa “c”, ku përcaktohet se subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

Grupi i Punës konstaton papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla**.

Bashkëlidhur raporti mbi subjektin e rivlerësimit **Adriatik Xhemal Llalla**.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

DREJTORI

Dorian TOLA



[Handwritten signature of Dorian Tola]